



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01.Nr. 16-30575/15
Kaçanik, 29. 09. 2015

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040- Për Vetëqëverisjen Lokale(Gazeta Zyrtare Nr. 28 e datës 4 qershor 2008), lidhur me nenin 19 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-233- Për Mbrojtjen e Natyrës(Gazeta Zyrtare Nr. 85 e datës 9 nëntor 2010), si dhe Rekomandimit të Agjensionit për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë Nr.3644/15, të datës 14.07.2015, i cili vepron në kuadër të MMPH, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 29 shtator, 2015, mori këtë:

VENDIM

**Për mbrojtjen e vlerës së natyrës ” Guri i Zi”, në fshatin Llanishtë,
si monument i natyrës**

1. Me këtë Vendim merret nën mbrojtje vlerë e natyrës ” Guri i Zi”, i cili gjendet në fshatin Llanishtë- Komuna e Kaçanikut si monument i natyrës të karakterit gjeomorfologjik – gjeologjik (në tekstin e mëtejme : Monumenti i Natyrës).

1.1. Monumenti i natyrës ndodhet në fshatin Llanishtë, në koordinatat :**LAT:** 42.224049 , **LONG:** 21269536, ngastra kadastrale nr.00343-2, Z.K-le Kaçanik, gjërësia e gurit është rreth 6 m ndërsa gjatësia 13 m.

1.2. I njejti ndodhet në lartësinë mbidetare prej 620 m dhe ka ngjyre të zezë, karakterizohet me plasaritje të shumëta.

2. Monumenti i natyrës spas IUCN-it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III-të Natural Monument/ Natural Landmark –Monument i Natyrës.

2.1. Për monumentin e natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III-të, të mbrojtjes në të cilin përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

2.2. Në monumentin e natyrës ndalohet:

2.2.1. Çfarëdo lloji të eksploatimit,

2.2.2. Çfardo lloji të degradimit në zonën mbrojtëse,

2.2.3. Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur,

2.2.4. Mbjellja e bimëve të tjera në kompleksin e pishave,

2.2.5. Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur ,

2.2.6. Ndryshimi i pamjes së sipërfaqes së mbrojtur,

2.2.7. Çdo lloj aktiviteti tjetër që mund të shkaktojë ndryshimin apo dëmtimin e monumentit të natyrës.

2.3. Në monumentin e natyrës lejohen:

2.3.1. Të gjitha masat mbrojtëse biologjike-teknike të monumentit të natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të projektit për sanimin e gjendjes së monumentit të natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes së monumentit të natyrës.

3. Në zonën buferike të Monumentit të Natyrës ndalohej:

3.1. Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi mbeturinave dhe mbetjeve tjera ,

3.2. Ndërrimi kulturës,

3.3. Ngjitja e objekteve të cilat kanë ndikim në pengimin e pamjes së monumentit të natyrës.

4. Për zbatimin e masave mbrojtëse të monumentit të natyrës kujdeset Komuna e Kaçanikut.

4.1. Komuna është e detyruar :

4.1.1. Monumentin e natyrës ta mbrojë dhe ta mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara mbrojtëse,

4.1.2. Në rast të paraqitjes së ndryshimeve të cilat monumentin e natyrës mund ta shkatërrojnë ose ti dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tyre, menjëherë duhet të lajmërohet në Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës,

4.1.3. Të bëjë shenimin e kufinjëve të monumentit të natyrës në pajtim me Rregulloren për Shenjimin e Zonave të Mbrojtura.

5. Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, baza ekonomike-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e monumentit të natyrës.

6. Ky Vendim pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokolit të autoritetit mbikqyrës-MAPL-së, si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

7. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit,
3. Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike,
4. Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, dhe
5. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi

